



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Muhamet Mucici B.I.” të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Muhamet Mucici B.I.” të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 07.07.2025 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Muhamet Mucici B.I.” (tutje “parashtruesi”) me datë 14.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1

Andaj duke marrë për bazë dispozitat ligjore të LPP-se, ne si OE me palë me interese sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-se, edhe për kundër faktit se ne kemi arritur të plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes të percaktuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirepo AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke na eliminuar padrejtësisht, duke na diskriminuar, NE si OE po detyrohemi të parashtrijm Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK duke pasqyruar dhe një herë faktet dhe argumentet lidhur me ARSYTIMIN NGA AK PËR ELEMNIMIN TONË si në vijim po citojmë:

ARSYTIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OE-ik nuk keni oferte të papërgjegjshme për arsye se GOE-ik me ofertën e tij nuk ka dorezuar sipas kërkesë së DT-së dhe njoftimit për kontratë:

Pika 4. 1) (Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmojnë me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmojë edhe me kontratë mbi qeramarëjen për këtë projekt..., ju ne ofertën tuaj keni paraqitur pasitë tjetër në kundërshtim, për këtë arsye oferta e juaj është e pa përgjegjshme.

Ky arsyetimi nga AK – zyrtari i prokurimit, dëshmon shumë qartë dhe bindës se nuk është vlerësuar dhe me qëllim jemi eliminuar, për faktin se teksti tregon ku thotë po citojmë: “nuk keni oferte të papërgjegjshme për arsye se GOE-ik me ofertën e tij nuk ka dorezuar sipas kërkesë së DT-së dhe njoftimit për kontratë:” që i bie se teksti “nuk keni oferte të papërgjegjshme” d.m.th. edhe ata e din se vërtet kemi ofertë të përgjegjshme, po ashtu nuk jemi grupi i OE po jemi vetëm një OE etj.....

Po ashtu, nëse e marrim për bazë edhe Letren standarde të sqarimit të tenderit të datës 14.05.2025 të cilën e kemi pranuar nga AK, përmes platformës elektronike, që kërkon sqarime pikërisht për staf dhe “Automikser për prodhim të betonit” si dhe përgjigjen tonet e datës: 16.05.2025 ku kemi sqaruar në mënyrë të DETAJUAR sa i përket AUTOMIKSERIT për prodhimin e mikserit, duke ofruar të gjitha dëshmitë me dokumente dhe regjistrim valid dhe sqarimi në teresi për këtë paisje që dot e thotë se janë në pajtim të plote me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë – duke plotësuar në teresi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor të dhenies së kontratës- çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ky fakt dhe argumente dëshmon dhe argumenton se ne kemi plotësuar në teresi këtë kërkesë të DT dhe NJK, duke dorezuar të gjitha ndashmit në lidhje me këtë paisje, por AK – Komisioni i vlerësimit, qëllimisht ne eliminon dhe ne Letren standarde të eliminimit nuk e jap asnjë edhe një faktet e vetëm se pse ne nuk kemi arrit të plotësojmë këtë kërkesë, pike të dosjes së tenderit, por vetëm thotë po citojmë: “ju ne ofertën tuaj keni paraqitur pasitë tjetër në kundërshtim, për këtë arsye oferta e juaj është e pa përgjegjshme”. që i bie se AK edhe pas sqarimeve të kërkuar dhe dorzimit të sqarimeve nga jona është dashur të theksojë dhe argumentojë se për cilat arsye apo/ose fakte, ne si OE nuk kemi plotësuar, kur tashmë janë në e-prokurim dhe kemi dorezuar gjithë dëshmitë dhe provat për këtë pajisje AUTOMIKSER PËR PRODHIM TË BETONIT, mirepo AK ne letren standarde nuk jap asnjë fakt apo dëshmi pse ne nuk e plotësojmë këtë kërkesë?..... Shpresojmë dhe lusim AK të na jap përgjigje konkrete me këtë KpR duke u thirrë në PROVA dhe FAKET dhe dispozite ligjore dhe jo vetëm në emocione dhe të thena të pa vërteta dhe pa argument konkretë!..... NE edhe në një kohë po theksojmë se kemi dorezuar të gjitha faktet dhe provat, Listen maikenerise/pajisjeve, marrëveshjen mbi qiranë, Librezat e qarkullimit, sigurimin nga Kompanitë e sigurimit me regjistrim valid, ashtu si qeshtë kërkuar në DT dhe NJK.

Prove: Dokumente me rastin e Tenderit për këtë AP, si dhe dëshmitë dhe faktet në sqarimet e letres standarde të sqarimit të tenderit dt. 14.05.2025

AK me rastin e vlerësimit, eliminimit dhe krahasimit të tenderëve në letren standarde të eliminimit ka përshkruar dhe ka dhënë një përshkrim të eliminimit, pa asnjë fakt apo prove të VETMNE, vërehet lehtë se këtë e ka bërë ZPP dhe jo komisioni i vlerësimit duke mos dhënë asnjë prove me fakte dhe argumente por vetëm duke përshkruar dhe duke u thirrur në ndonjë dispozite ligjore që i mbështet këtë përshkrim që nuk kanë fakte dhe argumente konkretë. Ne ja rikujtojmë AK – ZPP dhe Komisionit të vlerësimit se Vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet në pajtim të plote me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së dhe jo të jep përshkrim dhe të thirret në supozime, dhe HAMENDSIME dhe të jep kahje krjet tjetër duke mos marrë për bazë kriteret e përzgjedhjes por të thirret në disa gabime tersisht minore dhe që nuk kanë asnjë ndikim në qëllimin e prokurimit dhe ekzekutimit të këtij AP sepse NE - OE kemi arrit të plotësojmë të gjithë në plotësi dhe në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-se ne jemi GOE të përgjegjshëm. Mirepo AK me vetedije dhe qëllim të caktuar na eliminon padrejtësisht dhe duke na diskriminuar vetëm e vetëm për të mos na rekomanduar për kontratë, ne shklej të nenit 62 të LPP-se, e eliminon në teresi këtë AP

Me fjalët jera ne besojmë se AK do të reflektojë dhe të veproj në pajtim të plote me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje duke kërkuar AK të kthejë në rivlerësim dhe të na rekomandojë për dhenie të kontratës pasi që ne kemi tenderuar me çmimin më të lirë dhe të përgjegjshëm, andaj AK – ZPP me rastin e eliminimit tonë dhe anulimi të AP është në shkelje të nenit 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-se dhe parimit kryesor të prokurimit “vlera për para”.

AK ne me rastin e tenderimit ne kemi dorezuar Automikses per prodhimin e betonit, duke plotesuar Kërkesat e përshtatshme të profesionalenit 7.1 & 7.2 te FDT-se si ne vijim:

4. OE duhet të dëshmojë se ka në dispozicion pajisjet për realizimin e projektit.

f) 1 (Një) eskavator me rrota gome min 22 ton
i) 1 (Një) automikser per prodhimin e betonit (me regjistrim valid)

4. Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontraten në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qeramarrjen per kete projekt.

Prandaj, ne kemi plotesuar kete kërkesë te dosjes se tendeirt dhe NJK ne tersi si dhe kemi tenderuar me çmimin me te ulet te pergjegjshem dhe AK eshte i obliguar te na rekomandoj per dhenie te kontrates.

Pretendimet ankimore drejtuar ndaj OE te cilat kane tenderuar me cmim me te ulet po jane te papegjegjshem, pasi nuk kana rritur te plotesojn kriteret e përzgjedhjes te percaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftimi per Kontrate, si ne vijim te kesja KpR me posht:

Arsyet eliminuese të parashtruesit sipas letrës standarde janë si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OE-ik nuk keni oferte të papërgjegjshme për arsyes se GOE-ik me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës se DT-se dhe njoftit ut për kontrate:

pika 4. i) 1 (Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qiramarrjen për këtë projekt, ju ne ofertën tuaj keni paraqitur paisie tjetër ne kundërshtim, për këtë arsye oferta e juaj është e pa përgjegjshme.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 par. 4 si dhe nenin 62 të LPP me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të pjesërisht qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.07.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.